



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË
KRYETARI

Nr. 70 Prot.,

Tiranë, më 5.03.2024

URDHËR

Nr. 11, datë 5. 03. 2024

**“Për paraqitjen e dokumentacionit pranë Komisionit financiar të Qendrës
Kombëtare të Kinematografisë”**


Në zbatim të dispozitave të Ligjit nr.8096, datë 21.03.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, Rregullores së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë nr. 57 Prot., datë 27.01.2023, Kapitulli IV, Paragrafi III, si dhe Urdhërit të Ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 78, datë 27.02.2024, “Për ngarkimin e detyrave të Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”,

URDHËROJ:

1. Producentët që kanë përfituar mbështetje financiare nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë do të paraqesin pranë Komisionit Financiar dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Dokumentacionin financiar origjinal, ku përfshihen faturat dhe mandat pagesat për likuidimin e tyre);
 - Situacionin e shpenzimeve të kryera për këstin e financimit të alokuar;
 - Kërkesë për ndryshim të zërave të preventivit (në rast se ka).
2. Dokumentacioni do të paraqitet dorazi dhe do të inventarizohet nga Komisioni Financiar.
3. Nuk do të pranohet asnjë dokument fotokopje, apo të skanuara me e-mail.
4. Komisioni Financiar, ka të drejtë të shqyrtojë dokumentacionin brenda 10 ditë pune. Në rast se evidentohet parregullsia në dokumentacionin financiar të depozituar, apo lind nevoja për paraqitje të dokumentacionit shtesë, ky afat shtyhet.
5. Ngarkohet Komisioni Financiar me njoftimin dhe zbatimin e këtij urdhëri, i cili hyn në fuqi menjëherë.

I ngarkuar me detyrat e Kryetarit

Arben LAMI



Rr: “Aleksandër Moisiu” Nr 77, Tiranë

Tel. +355 42 378 004

E-mail: info@nationalfilmcenter.gov.al

Web: www.nationalfilmcenter.gov.al